



**KUJTESA NET**

**Fiton PEJA**

**Drejtor**

**Prishtinë**

**Ref:1912/1414 /KPM/mf**

### VENDIM

#### **Lidhur me Ankesën nr. 2019/47 ART MOTION (Palë Ankuese) kundër KUJTESA NET ("Palë Përgjegjëse")**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 4 korrik 2019 ka pranuar një ankesë të parashtruar Pala Ankuese ndaj Palës Përgjegjëse. Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse është duke e ritransmetuar kanalën ALSAT M pa të drejta të ritransmetimit, kanal për të cilin Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për territorin e Kosovës.
3. KPM gjithashtu me datën 18 korrik 2019, ka pranuar një shkresë nga ALSAT M, përmes të cilës KPM është njoftuar se ALSAT M ka bërë shkëputjen e kontratës me Koscable nëpërmjet së cilës Pala Përgjegjëse e ka siguruar të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT-M për Territorin e Republikës së Kosovës.
4. KPM, nëpërmjet një shkrese me datën 16 gusht 2019, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse, për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda afati dhjetë ditësh të ofrojë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT M.
5. KPM me datë 2 shtator 2019, ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse lidhur me shkresën duke cekur se kontratën me ALSAT M e ka rideponuar në KPM dhe se është valide deri në vitin 2020.

6. KPM, pas analizimit të të gjeturave në lidhje me këtë rast, me datën 17 shtator 2019, i ka dërguar Palës Përgjegjëse një shkresë përmes të cilës e ka njoftuar se KPM ka pranuar një njoftim nga Alast M për shkëputje të kontratës dhe ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke e larguar kanalën "Alsat M", nga transmetimi menjëherë pas pranimit të kësaj letre, në të kundërtën Zyra Ekzekutive e KPM-së do t'i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së. Pala Përgjegjëse është njoftuar se sipas ALSAT M të drejtën ekskluzive të ritransmetimit të kanalit ALSAT M e siguron Pala Ankuese.
7. KPM në lidhje me shkresën e datës 17 shtator 2019, ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse me datën 23 shtator 2019, duke potencuar se kontrata me Alsat M është është vlefshme deri në vitin 2020 dhe se e ka të drejtën e ritransmetimit të kanalit ALSAT M.
8. KPM në bazë të shkëputjes së njëanshme të kontratës nga ana e ALSAT M ka gjetur se Pala Përgjegjëse, vazhdon të ritransmetojë kanalën ALSAT M pa marrëveshje valide për të cilin kanal ka të drejtë ekskluzive për territorin e Kosovës Pala Ankuese.
9. KPM poashtu me datën 26 nëntor 2019, ka pranuar edhe një shkresë tjetër nga ALSAT M, përmes të cilës KPM është njoftuar përsëri se ALSAT M ka bërë shkëputjen e kontratës me Palën Përgjegjëse.

#### Analiza Ligjore

10. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

*"I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale."*

11. KPM-së, duke u bazuar në njoftimin e dhënësit të të drejtave Alsat M për shkëputje të kontratës me Palën Përgjegjëse, ka gjetur se marrëveshja e Palës Përgjegjëse me Alsat M është ndërprerë dhe se Pala Përgjegjëse nuk ka me të drejtë të transmetojë kanalën Alsat M. Pala Përgjegjëse edhe përkundër kësaj ka vazhduar me transmetimin e kanalit Alsat M duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01.
12. Bazuar në kontratën e deponuar në KPM nga Pala Ankuese si dhe bazuar në njoftimin e dhënësit të të drejtave Alsat M, është gjetur se të drejtat ekskluzive të bartjes së kanalit Alsat M për territorin e Kosovës i ka siguruar Pala Ankuese.
13. KPM gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01 i cili përcakton se:

